



Planuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivery	24.10.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ/Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	6415/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.792/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, më Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.792/2022 të datës 12.09.2022, të parashtruar nga ankuesja _____ nga _____ kundër Vendimit Nr.05/2022 të datës 12.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.792/2022 e datës 12.09.2022 e parashtruar nga ankuesja _____
- II. *Shfuqizohet* Vendimi Nr.05/2022 i datës 12.08.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe *çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë*.
- III. *Obligohet* Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja _____ e punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 12.09.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokoll 5310/2022, kundër Vendimit Nr.05/2022 të datës 12.08.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për shkak të paligjshmërisë së aktit të inicimit të procedurës disiplinore, shkeljeve të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mos

shqyrtim i provave në mënyrë të drejtë, trajtim diskriminues dhe cilësim të paligjshëm të shkeljes disiplinore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa kjo e fundit më datë 29.09.2022, 11.10.2022 dhe 12.10.2022 ka përcjell shkresat ndërlidhur me çështjen në shqyrtim dhe vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5310/2022 të datës 12.09.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin mjekësor nga _____ të datës 07.02.2022; Raport nga Poliklinika dhe Laboratori _____ të datës 09.02.2022; Raport nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës i datës 11.02.2022; Raport nga Pe Medika në Shkup i datës 03.06.2022; Vendimin me Nr.162/2022 të datës 04.03.2022 për formimin e ekipit punues për hartimin e koncept dokumentit të kulturës; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses e datës 14.07.2022; Njoftimin për inicimin e procedurës disiplinore për ankuesen i datës 15.07.2022; Vendimin me Nr. 05/2022 të datës 12.08.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Emailin e datës 07.03.2022, 08.03.2022 nga ankuesja për _____ Emailin e datës 07.03.2022, 08.03.2022 nga _____ për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 13.09.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 29.09.2022, 11.10.2022 dhe 12.10.2022; Deklaratën nen betim sipas kërkesës së KPMSHCK-së e datës 29.09.2022 nga _____ Ftesë për takim në Komisionin Disiplinor e datës 25.07.2022; Akt Emërimit me numër protokollit 161/2012-06 i datës 20.01.2012 për ankuesen; Përshkrimin e detyrave të punës për Udhëheqës Divizionit të Promovimit të Kulturës i datës 26.03.2013; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 26.01.2022; Emailin e datës 04.03.2022 nga _____ Deklaratën e datës 27.07.2022 nga _____ Raport Ultrazëri nga ECHO-SOPI për ankuesen i datës 08.02.2022; Fotografi Ultrazëri; Kuponin Fiskal i datës 03.06.2022; Kërkesë për pushim vjetor nga ankuesja i datës 23.12.2021, 30.03.2022, 11.05.2022, 10.08.2022; Raport me rezultatin laboratorik i datës 26.0.2022; Raporti i ndërprerje së përkohshme për punë i datës 16.05.2022, 20.07.2022; Procesverbalin e datës 26.07.2022 të Komisionit Disiplinor; Ftesë për komision disiplinor e datës 25.07.2022 për ankuesen; Njoftimin e datës 11.10.2022 për Procesverbalin e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Lëshimin e Vërtetimit për Sponzorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit datë 01-02.08.2022, 09.06.2022, 10.03.2022, 12.04.2022, 18.07.2022, 22.07.2022, 23.03.2022, 26.04.2022, 30.06.2022, 30.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi që ka nxjerrë aktin administrativ të kundërshtuar me ankesë, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, gjegjësisht sipas Akt-it të Emërimit me numër protokollit 161/2012-06 të datës 20.01.2012 e njëjta është emëruar dhe vazhdon të ushtroj pozitën e punës "Udhëheqëse e Divizionit të Promovimit të Kulturës".

Me tej nga vlerësimi i shkresave të lëndës Kolegji gjen se Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Vendimin Nr.162/2022 të datës 04.03.2022 ka formuar Ekipin Punues për Hartimin e Konceptdokumentit për Kulturën, ku ankuesja është caktuar kryesuese e këtij ekipi. Më datë 07.03.2022 ankuesja ka njoftuar Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit se prej tri (3) javësh është diagnostikuar më gjëndrën tiroide si dhe gjendja nuk është aq e mirë, duke kërkuar largimin e saj nga kryesuesja e grupit punës për hartimin e Konceptdokumentit për Kulturën, ndërsa Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes emailit të datës 07.03.2022 ka njoftuar ankuesen që kërkesat e tilla nuk janë aprovuar asnjëherë dhe si të tilla duhet të kenë mbështetje në procedura ligjore dhe dëshmi përkatëse, kështu që ka udhëzuar ankuesen që të vazhdoj me punën e grupit punues. Pas kësaj përgjigje, ankuesja më datë 08.03.2022 ka dërguar raportet mjekësore, ndërsa Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka udhëzuar ankuesen që të vazhdoj me rregullim e procedurave me Divizionin e Burimeve Njerëzore për pushim mjekësor dhe ndërkohë në vend të ankueses ka caktuar zëvendësuesen.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes kërkesës me numër protokollit 3052/2022 të datës 14.07.2022 ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankueses me arsyetim se ankuesja ka refuzuar zbatimin e vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm, ka ndikuar që pozita e saj të ngelet jofunksionale në një proces të rëndësishëm, ka dështuar të demonstroj përgjegjësinë në nivelin e duhur përkitazi me respektimin e vlerave të ligjshmërisë dhe interesit publik, ka ndikuar që burimet njerëzore të Departamentit të Kulturës të mbingarkohen duke qenë se përveç koncept dokumentit, departamenti ka shumë programe e projekte tjera, ka rrezikuar krijimin e precedentëve negativ në stafin e Departamentit të Kulturës dhe MKRS, me pretendimin që e njëjta ka bërë shkelje të rënda të detyrave të parapara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit më datë 12.08.2022 me Vendimin Nr.05/2022, ka shpallur ankuesen përgjegjëse për shkelje të rënda të detyrave të punës sipas nenit 46 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1, paragrafi 3 nënparagrafi 3.1, 3.3 dhe 3.10 si dhe nenit 47 paragrafi nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, duke i shqiptuar masat disiplinore "ndalim për 30% në pagë për periudhën 3 maj dhe 3 vite ndalim gradini".

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë referuar procedurash disiplinore, përkatësisht:

Neni 45 ka përcaktuar se: " ... Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"

Neni 46 ka përcaktuar se: 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta.....

Neni 47 ka përcaktuar se: " Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"

Në kuptim të dispozitave ligjore të lartë cekura si dhe duke u bazuar në provat e administruara, Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor nuk ka vetëtuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen e fakteve lidhur me këtë çështje disiplinore, sepse sipas vendimit të kundërshtuar me ankesë është konstatuar se ankuesja edhe pse ka dërguar raportet mjekësore asnjëherë nuk ka hyr në pushim mjekësor por e njëjta ka vazhduar me i krye detyrat e tjera por nuk ka marrë pjesë në takimet e grupit punues për Hartimin e Koceptdokumentit për Kulturës, ndërsa Kolegji bazuar në provat e lëndës ka gjetur se ankuesja pas kërkesës për lirim, dy herë ka shfrytëzuar pushimin mjekësor dhe atë për periudhat kohore nga data 27.04.2022 deri më datë 16.05.2022 dhe nga data 18.07.2022 deri më datë 20.07.2022.

Kolegji i Këshillit në vështrim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të goditur me ankesë, po ashtu verën se arsyetimi i vendimit nuk përmban fare shpjegim të situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi dhe cilat shkaqe kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, andaj mbi këtë bazë dhe duke u bazuar në nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative *Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.*

Duke ju referuar shkresat të lëndës Kolegji gjen se Komisioni Disiplinor nuk ka ftuar në seancë dëgjimore iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore në këtë rast ankuesen për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit, dhe rrjedhimisht një mos veprim i tillë i Komisionit Disiplinor bie ndesh me nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë,

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Vendimin Nr.05/2022 të datës 12.08.2022 ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore *"ndalim për 30% në pagë për periudhën 3 maj dhe 3 vite ndalim gradimi"*, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale pasi që ka shqiptuar dy masa disiplinore dhe atë masën disiplinore të ndalimit të pagës sipas nenit 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe masën disiplinore sipas nenit 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 50 paragrafi 5 të këtij ligji ku është përcaktuar se: *"Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore"*.

Andaj, duke qenë se vendimi i atakuar përmban të meta të tillë të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit vlerëson që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj çështjen disiplinore lidhur me ankuesen, të eliminoj shkeljet e konstatuara sipas këtij vendimi dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative,

brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.792/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;;
- Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;